

PROCESVERBAL
nga seanca e 10-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 07.03.2025

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, dr. Metodija Jançeski, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë:/

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional përmes lidhjes video-konferencë:
mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Argjend Xhellili, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, Lazo Petrushevski hapi seancën e 10-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 09:35 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 2-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.02.2025.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 9-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.02.2025.
3. Propozim për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë.
4. Propozim-aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.
5. Propozim për dhënien miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - mallra: Leje softueri për bekapim automatik të të dhënave.
6. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të parashikuar nën pragun e vlerës për zbatim të Ligjit për furnizim publik.
7. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 2-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.02.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri e miratoi Procesverbalin e propozuar të seancës së 9-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 28.02.2025, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi propozimin për ndalim të procedurës për heqje të lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë. Ai shpjegoi se transmtuesi, pas inicimit të procedurës, ka paguar në tërësi kompensimin vjetor në afatin Ligjor shtesë prej 15 ditësh. Në bazë të kësaj, i propozohet Këshillit që të ndalon procedurën.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndalim të procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, PA1 nr.08-133 datë 07.09.2023.

Në pajtim me Njoftimin për pagesën e kryer nr.05-754/2 datë 06.03.2025, SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, kompensimin vjetor të lejes për transmetim në radio e pagoi plotësisht, sipas faturës së dorëzuar nr.2025-100-0069 datë 10.01.2025.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmenduar ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-aktvendimin për fshirjen e Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup nga regjistri i transmetuesve. Ai ka sqaruar se kemi të bëjmë me procedurë teknike, sepse pas heqjes së lejes është e nevojshme që transmetuesi të fshihet nga regjistri. Ai shpreson se në periudhën shtesë prej 30 ditësh do të arrijë të sigurojë mjete financiare dhe përmes padisë para Gjykatës Administrative, do t'i kthehet leja.

Z. Petrushevski theksoi se, nëse transmetuesi arrin t'i sigurojë mjete e nevojshme financiare, Këshilli do të mbështesë kthimin e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmenduar ta publikon në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për miratimin e procedurës për furnizim publik të mallrave – leje softueri për bekapim automatik të të dhënave. Ajo shpjegoi se qëllimi i furnizimit është të sigurojë ruajtjen e të dhënave të Agjencisë dhe mbrojtja nga kërcënime të mundshme që mund të

rrezikojnë sigurinë e sistemeve të IT. Furnizimi është i paraparë në Planin Vjetor për furnizim publik, ndërsa mjetet janë të parashikuar në Planin Financiar të Agjencisë. Duke pasur parasysh vlerën e parashikuar, procedura do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët, që do të thotë se do të fillojë me publikm përmes sistemit elektronik për furnizim publik. Të gjitha informacionet shtesë për këtë procedurë janë paraqitur në materialet e dorëzuara për seancë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-mallra: Leje softueri për bekap automatik të të dhënave.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën: Leje softueri për bekap automatik të të dhënave, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizim publik për vitin 2025 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-5321/1 datë 27.12.2024, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Pika 6

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska, shpjegoi Propozimin për miratimin e marrjes së vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të parashikuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik. Ajo shpjegoi se Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim ka dorëzuar njoftim në ASHMA, ku thuhet se Agjencia duhet të përgatisë Plan për Mbrojtjen dhe Shpëtim nga fatkeqësi natyrore dhe aksidente të tjera, bazuar në vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësi natyrore dhe aksidente të tjera, si dhe Rregulloren për mbrojtjen nga Zjarret dhe Shpërthime. Meqënëse Agjencia nuk ka ekspertizë të brendshme për përgatitjen e këtyre dokumenteve dhe duke marrë parasysh vlerën e parashikuar të furnizimit, është konstatuar se do të kryhet nën pragun e vlerës, që do të thotë se dispozitat e Ligjit për furnizim publik nuk vlejnë për të. Është dorëzuar kërkesë drejtuar Drejtorit, i cili ka miratuar mjete në shumë prej 60.000,00 denarë për këtë furnizim. Janë paraqitur tre oferta, ku oferta më e ulët i përshtatet shumës së parashikuar. Në bazë të kësaj, propozohet t'i jepet miratim drejtorit për realizimin e furnizimit, sipas asaj që thuhet në materialet.

Z. Petrushevski theksoi se shpjegimi i udhëheqëses ishte korrekt dhe se në të nuk ceket ofruesi, por vetëm aspektet financiare të furnizimit. Po ashtu duhet cekur dhe në konkluzën e pikës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që drejtori i Agjencisë të marrë Vendim me të cilin miratohen mjetet financiare në shumë prej 60,000.00 pa TVSH (70.800,00 denarë me TVSH), për furnizim me vlerë të parashikuar nën pragun e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizim publik, për furnizim të shërbimit – përgatitja e: Vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësi natyrore dhe aksidente të tjera, Rregollren për mbrojtjen nga zjarri dhe shpërthime dhe Plan për mbrojtjen dhe shpëtim nga fatkeqësi natyrore dhe aksidente të tjera.

Për realizimin e furnizimit të lartpërmendur mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2025.

Pika 7

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën të Ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**